

## Forma e raportit

### Raporti Vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm

Për periudhën prej 01/01/2020 deri 31/12/2020

<b>I Pjesa e përgjithshme</b>		
<b>1. Të dhënat e përgjithshme për shfrytëzuesin e buxhetit (Subjektin e sektorit publik)</b>		
Subjekti sektorit publik (SSP):	Komuna e Gjakovës	
Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:	Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës.	
Emri dhe mbiemri i Drejtorit/ Auditorit të NjAB:	Z. Blerim Morina	
Telefoni:	E-mail: blerim.s.morina@rks-gov.net	
<p><b>Qëllimi i raportit gjashtëmujor/vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm:</b></p> <p>Raportimi tek Ministria e Financave - Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm lidhur me auditimet e kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm si dhe të dhënave të nevojshme për përpilimin e raportit unik (përmbledhës) gjashtëmujor/vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik.</p>		
<p><b>Roli dhe qëllimi i auditimit të brendshëm:</b></p> <p>"Auditimi i brendshëm" është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të përmbush objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të rezikut, kontrolleve dhe qeverisjes.</p>		
<b>2. Të dhënat për Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm</b>		
2.1 Njësia e Auditimit të Brendshëm është themeluar sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike		PO
2.2 Nëse përgjigja është JO - thekso arsyet		
2.3 Njësia e auditimit të brendshëm është themeluar sipas njërës nga mënyrat si në vijim:		
<ul style="list-style-type: none"> <li>a) <u>Njësi e pavarur të auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejt të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik;</u></li> <li>b) Njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Financave;</li> <li>c) Njësi e marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër, me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo</li> <li>d) Njësi kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.</li> </ul>		
2.4 Njësia e auditimit të brendshëm në mënyrë organizative i përgjigjet drejtpërsëdrejti dhe ekskluzivisht Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik		PO
2.5 Nëse përgjigja është JO - thekso kujt i përgjigjet dhe arsyet:		
2.6 A është plotësuar Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave ligjore		JO
<b>Kërkesat minimale ligjore për numrin e auditorëve</b>	<b>Numri aktual i auditorëve</b>	<b>Burimet e nevojshme për auditim</b>

4	1	3
2.7 Nëse përgjigja është JO - atëherë thekso arsyet për mos plotësimin e njësisë me numrin minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore: Mungesa Buxhetore (mos planifikimi korrekt buxhetor)		
2.8 Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm a janë të çertifikuar sipas kushteve të parapara me ligj:		PO
2.9 Nëse përgjigja është JO thekso arsyet:		
2.10 Auditorët e brendshëm kryejnë vetëm punët e auditimit të brendshëm:		PO
2.11 Nëse përgjigja është JO - atëherë duhet theksuar cilat punë i kryen dhe cilat janë arsyet:		
2.12 Auditorët e brendshëm kanë qasje të plotë, të lirë dhe të pakufizuar te:		
a) Të gjithë dokumentacioni:		PO
b) Të dhënat dhe informatat tek të gjithë bartësit e të dhënave:		PO
c) Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:		PO
d) Personeli (udhëheqësi dhe të punësuarit):		PO
e) Pasuria materiale:		PO
2.13 Nëse përgjigja është JO - duhet theksuar arsyet:		
<b>Buxheti i subjektit të sektorit publik</b>		
2.14 Paga dhe rrogat		16,053,829.00
2.15 Mallra dhe shërbime		3,004,103.00
2.15.1 Shpenzimet komunale		586,800.00
2.16 Subvencione dhe transfere		510,500.00
2.17 Kapitale		7,097,485.00
<b>Gjithsej buxheti</b>		<b>27,252,717.00</b>
2.18 Njësia e auditimit të brendshëm ka buxhetin e ndarë		JO
2.19 Nëse përgjigja është PO - sa është buxheti i saj		
2.20 Nëse përgjigja është JO - në cilin departament është i vendosur buxheti i Njësisë së auditimit të brendshëm:		
<b>3. Zbatimi standardeve dhe metodologjisë së punës së Auditimit të Brendshëm</b>		
<b>Zbatimi i Doracakut të auditimit të brendshëm</b>		
3.1 Auditorët e brendshëm kanë një ekzemplar të Doracakut të auditimit të brendshëm:		PO
3.2 Auditorët e brendshëm, përpos Doracakut të auditimit të brendshëm kanë edhe shtesën e vet të doracakut për auditim të brendshëm		JO
3.3 Nëse përgjigja është PO - a është kërkuar pëlqimi te NjQH/AB për shtesën e doracakut:		PO JO
3.4 Nëse përgjigja te pika 3.3 është JO - të theksohen arsyet		
3.5 Auditorët e brendshëm në kryerjen e auditimeve të veçanta/me kërkesë u përmbahen në tërësi fazave të proceseve të auditimit të përcaktuara me Doracakun e auditimit të brendshëm		PO
3.6 Nëse përgjigja është JO - theksoni arsyet:		
<b>Statuti i auditimit të brendshëm</b>		
3.7 Njësia e auditimit të brendshëm ka statutin e auditimit të brendshëm		PO
3.8 Nëse përgjigja është JO - theksoni arsyet:		

3.9 Statuti i auditimit të brendshëm është i nënshkruar nga Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Drejtori i Njësisë së AB:	PO					
3.10 Nëse përgjigjja është Po - shkruaj datën e aprovimit të statutit: 12/04/2011						
<b>Zbatimi i kodit të etikës profesionale të AB</b>						
3.11 Auditorët e brendshëm i përmbahen parimeve dhe rregullave të përcaktuara me Kodin e etikës profesionale:	PO					
3.12 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet dhe rastet e mos përmbajtjes:						
<b>Kryerja e auditimit të brendshëm</b>						
3.13 Plani strategjik i auditimit të brendshëm është përpiluar në bazë të vlerësimit të rrezikut:	PO					
3.14 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:						
3.15 Planin strategjik të auditimit të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit	PO					
3.16 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet: nuk ka qenë i themeluar komiteti i auditimit						
3.17 Plani vjetor i AB është hartuar në bazë të Planit strategjik të AB:	PO					
3.18 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:						
3.19 Planin vjetor të AB të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit:	PO					
3.20 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:						
3.21 Subjekti i sektorit publik ka themeluar Komitetin e Auditimit	PO					
3.22 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:						
<b>Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm</b>						
3.23 Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij ( për të cilat janë përpiluar raportet finale )						
<b>Periudha raportuese</b>	<b>Numri i auditimeve të planifikuara</b>	<b>Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit</b>	<b>Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim</b>	<b>Numri i auditimeve të kryera</b>	<b>Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit</b>	<b>Numri i auditorëve të angazhuar për auditim</b>
Gjashtëmujori I	1	35	1	1	35	1
Gjashtëmujori II	2	70	1	2	70	1
Vjetore	3	105		3	105	
3.24 Arsyet për mos kryerjen e auditimeve sipas numrit të planifikuar të auditimit të brendshëm - theksoni arsyet:						
3.25 Auditimet e planifikuara dhe realizuar me kërkesë të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik						
<b>Numri i auditimeve të planifikuara me kërkesë</b>	<b>Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit</b>	<b>Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim</b>	<b>Numri i auditimeve të realizuara</b>	<b>Koha shpenz. për auditimin me kërkesë</b>	<b>Numri i auditorëve të angazhuar</b>	
0	0	0	0	0	0	
3.26 Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet finale të auditimit menjëherë pas kryerjes së AB						PO
3.27 Nëse përgjigjja është JO - Theksoni si i dërgohen Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik raportet finale të auditimit:						

a) Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen të gjitha raportet e auditimit në fund të periudhës raportuese;	
b) Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet e auditimit kohë pas kohe;	
c) Në mënyrë tjetër (theksoni si)	
3.28 Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik përpilon dhe vendos për planin e veprimit i cili përfshinë rekomandimet e pranuar dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren në pajtim me ligjin për KBFP	PO
3.29 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:	
3.30 Për rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit njësia për auditimit të brendshëm ka bazën e organizuar të dhënave për zbatimin e rekomandimeve:	PO
3.31 Nëse përgjigjja është JO - theksoni arsyet:	
3.32 Rekomandimet e dhëna përcjellën sipas planit të veprimit, ashtu sikur është përcaktuar me doracak të auditimit të brendshëm	PO JO
3.33 Nëse përgjigjja është JO - thekso arsyet:	
<b>Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:</b>	
3.34 Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:	9
3.35 Numri i rekomandimeve të zbatuara:	5
3.36 Numri i rekomandimeve në proces:	1
3.37 Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	3
3.38 Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara thekso arsyet e moszbatimit:	
<b>II Pjesa e veçantë</b>	
<b>1. Pasqyra e auditimeve të kryera dhe ndryshimi nga plani vjetor i auditimit, duke theksuar arsyet e ndryshimit ose moskryerjes së auditimeve të planifikuara</b>	
Thekso të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese me të gjeturat dhe rekomandimet, dhe drejtimi i shkurt për secilin auditim.	
1.1 Emërtimi i auditimit: Auditimi i Drejtorisë Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë për periudhën 2019 deri 2020	
Të gjeturat:	
1. Tejkalim i afatit ligjor për regjistrimin e pronës. Gjatë zhvillimit të auditimit në Drejtorinë e Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë, i testuam 12 mostra:	
Numri i Lëndës:	
1389 / 2020	
42/343 / 2019	
37/659/ 2019	
35973 / 2019	
35979 / 2019	
37725/ 2019	
4182/ 2020	
39794 /19	
38714/19	

38559/19  
37954/19  
37610/19

Testimi i këtyre dymbëdhjetë mostrave është bërë për pajtueshmërinë dhe për performancën e tyre, nga këto dymbëdhjetë mostra rezultojë vetëm një me mangësi në respektimin e afatit ligjor, po ashtu rezultuan edhe tre mostra me vonesë, por për arsye se lëndët janë proceduar me mangësi nga iniciuesi i kërkesës për regjistrim.

Po ashtu gjatë testimit vërejtëm si karakteristike të përbashkët për të gjitha mostrat që nuk mbahet ndonjë evidencë lidhur me njoftimin zyrtar të pronarëve të ri në lidhje me regjistrimin e pronës me qëllim që të vijë dhe të tërheq aktvendimin.

2. Vonesa në deponimin e parasë së gatshme në llogarinë bankare.

Gjatë zhvillimit të auditimit në Drejtorinë e Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë, ne kemi vërejtur se arkëtimet e mbledhura nga taksat, ishin deponuar me vonesë në bankë zakonisht deponimi është bërë një herë në javë.

Kjo dukuri ka ndodhë edhe para vitit 2019 gjatë vitit 2019 po ashtu edhe gjatë vitit 2020.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të pa mjaftueshme të mbikëqyrjes nga niveli menaxherial.

3. Mungesa e shpalljeve informuese dhe sensibilizuese, "se si ta regjistroj të drejtën pronës"

Gjatë zhvillimit të auditimit në Drejtorinë e Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë, ne kemi vërejtur se edhe pse donatorët kanë sponsorizuar fushatë mediale dhe sensibilizuese po ashtu i kanë ofruar Komunës edhe shpallje informuese sensibilizuese falas, Komuna nuk është kujdesë që këto shpallje informuese të mirëmbahen dhe të afirmohen që të kenë një ndikim sa më të madhë në sensibilizim.

Rekomandimet:

1. Rekomandojmë menaxhmentin që lëndët të përpunohen brenda afateve ligjore.

Në rast se lënda kthehet për ndonjë arsye, atëherë në dosje të lëndës, të shkruhet një shkresë që tregon për arsyet e vonesës së përpunimit të lëndës.

Rekomandojmë menaxhmentin që pas miratimit të regjistrimit të ri të pronës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ta njofton pronarin e ri (për të ardhur në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për ta marrë kopjen e certifikatës së pronësisë dhe Vendimit për bartje të pronës në emër të pronarit të ri).

2. Rekomandojmë menaxhmentin që të përmisoj kontrollet e brendshme dhe njëherësh të bëjnë zbatimin e Neni 11 i Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat.

*Neni 11*

*Mbledhja e parave në formë parsh të gatshme*

....

*Në fund të ditës paratë e grumbulluara në arkat e OB-ve duhet të depozitohen në total për çdo lloj të të hyrave përmes agjencive mbledhëse me faturë përmbledhës të përcaktuar me numrin identifikues UNIREF.*

...

3. Rekomandojmë menaxhmentin që të kujdeset për mirëmbajtjen dhe vendosjen e shpalljeve informuese dhe sensibilizuese se si të bëhet regjistrimi i të drejtës së pronës.

Përmbajtja e shkurt e drejtimit (përshkruaj objektivat):

Në pajtueshmëri me testet tona objektivat e këtij auditimi janë:

Të japim një siguri të arsyeshme në lidhje me planifikimin dhe raportimin në Drejtorinë Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë,

✓ Të japim një siguri të arsyeshme se të gjitha proceset në Drejtorinë Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë janë në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi,

✓ Të japim një siguri të arsyeshme se në mbledhjen e të hyrave është zbatuar në mënyrë adekuate Rregullorja komunale për tarifa dhe ngarkesa dhe janë marrë masa që të respektohen afatet ligjore gjatë procedurave.

Fushëveprimi i këtij Auditimi, është si vijon:

Fushëveprimi i këtij auditimi është fokusuar në Drejtorinë Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë dhe njësitë të cilat janë të involvuara në proces gjatë punës, si dhe mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me procesin i cili është audituar. Auditimi është kryer në Komunën e Gjakovës në Drejtorinë Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë dhe ky aktivitet ka mbuluar periudhën 2019-2020. Aktivitetet lidhur me këtë auditim përfshijnë, por nuk kufizohen në këto dokumente dhe procedura të shtjelluara:

- Planifikimin në Drejtorinë e Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë për vitin 2019 dhe 2020
- Raportin vjetor për realizimin e planit 2019 në Drejtorinë Për Gjeodezi, Kadastër Dhe Pronë
- Të hyrat për periudhën 2019 deri 2020
- Evidencat e lëndëve (sipas kërkesës) të cilat kanë aplikuar gjatë 2019 dhe 2020
- Si dhe dokumentacioni tjetër që nevojitet në auditim e sipër lidhur me këtë proces për periudhën 2019 deri 2020.

**1.2 Emërtimi i auditimit:** Auditimi i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa për periudhën 2019 deri 2020

Të gjeturat:

1. Mangësitë logjistike në sektorin e Tatimit në pronë. Gjatë zhvillimit të auditimit në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, i shqyrtuam raportet e punës për vitin 2019 dhe për vitin aktual 2020 të sektorit të tatimit në pronë. Gjatë auditimit gjetëm që gjatë vitit 2019 ka pas një numër jashtëzakonisht shumë të madh të ankesave të tatimpaguesve, të cilat ankesa si shkak i kanë gabimet në sistem të përlllogaritjes së tatimit në pronë nga ministria e linjës, po ashtu gjetëm që ky sektor ballafaqohet me mungesa në pajisje të teknologjisë informative, pajisjet të cilat janë në shfrytëzim janë të vjetra mbi 8 vite. Kompjuterët të cilët janë në përdorim janë kryesisht shumë të amortizuar dhe kanë Grafik dhe Monitor shumë të vegjël, pasi që pjesa e punës me harta digjitale kërkon kompjuter me performancë të lartë për procesimin e informacionit vizual. Po ashtu gjetëm që në këtë sektor ka mungesë të veturave për punë në teren, si ri anketimi, anketimi, etj. Realizueshmëria e planit në vitin 2019 ka qenë 99.63% ndërsa për shkak të pandemisë me COVID-19 ka pas një rënje të theksuar në vitin 2020, kështu që, realizueshmëria deri në muajin Tetor/ 2020 ka qenë 63.64%.
2. Vonesa në shpenzueshmërinë e disa zërave buxhetor të cilët kanë ndikim në ekonominë komunale lokale. Gjatë zhvillimit të auditimit në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, i shqyrtuam raportet e punës për vitin 2019 dhe për vitin aktual 2020 të sektorit të buxhetit gjetëm që, njësitë kërkuese përkatësisht Drejtoritë disa zëra buxhetor, fillojnë që të shpenzojnë me vonesë dhe rrezikojnë që këto mjete të mbesin në suficit buxhetor. Kategoritë buxhetore në fjalë janë këto:

"SUBVENCIONE DHE TRANSFERE" dhe "SHPENZIME KOMUNALE".

3. Menaxhimi i Pasurive ka trend dhe tendencë pozitive të menaxhimit por mungojnë linjat e sistematike të raportimit. Gjatë zhvillimit të auditimit në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, i shqyrtuam raportet e punës për vitin 2019 dhe për vitin aktual 2020 të sektorit të të hyrave në lidhje me evidencat dhe me arkëtimin e borxheve nga qiratë, gjetëm që edhe pse janë bërë përpjekje për mbledhjen e të hyrave nga qiratë nuk kanë qenë sistematike dhe të vazhdueshme. Gjetëm që mungon regjistri i përgjithshëm i të gjitha objekteve dhe pronave të lëshuara me qira. Po ashtu gjetëm që llogaritë e arkëtueshme nga qiratë nga viti në vit veç sa po rriten. Ndërsa aktivitetet për përmisimin kësaj situatë janë vetëm sporadike.

Rekomandimet:

1. Rekomandojmë menaxhmentin që sektorin e tatimit në pronë, ta ketë prioritet në kompletimin e logjistikës për punë të vazhdueshme. Të bëhet një vlerësim për nevojat në teknologji informative, si kompjuter dhe llap top me performancë të procesimit për punën me harta digjitale. Po ashtu me qëllim që ky sektor të përformoj sa më mirë është mase e domosdoshme që të ju caktohet një veturë e dedikuar për këtë sektor që të kenë mundësi të realizojnë planin pa pengesa për punë në teren.
2. Rekomandojmë menaxhmentin që t'i nxis drejtoritë që pa vonesë t'i shpenzojnë zërat buxhetor, në mënyrë sistematike sipas planifikimit buxhetor, po ashtu të raportojnë për dinamiken e shpenzueshmërisë.
3. Rekomandojmë menaxhmentin që të shtoj kontrollet lidhur me menaxhimin e të hyrave nga qiratë. Duke caktuar një zyrtar komunal që është përgjegjës për përgatitjen e një regjistri për të gjitha pasuritë e lëshuara me qira nga komuna e Gjakovës, Të gjitha drejtoritë t'i prezantojnë të gjitha kontratat për objektet e lëshuar me qira tek zyrtari në fjalë. Zyrtari në fjalë ta njoftoj menaxhmentin në baza mujore për nivelin inkasimit të të hyrave nga qiratë. Për qiramarrësit borxhlinjë të ndërmerren hapat ligjor për inkasimi të detyrueshëm përmes procedurave përbarimore nëse me njoftime dhe me letërkujtesë nuk i përmbushin në mënyrë të vullnetare obligimet sipas kontratës së nënshkruar.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat):

1.3 Emërtimi i auditimit:

Auditim i Sektorit të Prokurimit: 2019 deri 2020

Të gjeturat:

1. Gjatë auditimit gjegjësisht gjatë mbledhjes së informatave nga sektori i prokurimit lidhur me menaxhimin e kontratave (projekteve), konkretisht kërkesës tonë "për ofrimin e bazës së të dhënave për menaxherët e kontratave (projekteve)", rezultoi me një përgjigje jo të plotë nga sektori i prokurimit për "bazën e të dhënave" për menaxheret e kontratave (projekteve) si pasojë e mungesës së freskimit të informatave për menaxheret e kontratave (projekteve) në mënyrë periodike dhe sistematike.
2. Gjatë auditimit, përkatësisht shqyrtimit dhe analizimit të lëndës së prokurimit nr. 632-20-5107-5-2-1, gjetëm pa rregullsi në procesin e vlerësimit të ofertave si më poshtë:

Operatori Ekonomik me ofertën me çmimin më të ulët është eliminuar pa drejtësisht, me këtë arsytim: " Ju si operator lista e mjeteve-pajisjeve teknike të punës në dispozicion-dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve nuk e përmbush kërkesën në dosjen e tenderit." Ky arsytim është i paqëndrueshëm sepse dëshmitë të cilat i gjetëm në sistemimin E-Prokurimi, të cilat janë të depozituara në E-Prokurimit nga ana e OE, e dëshmojnë të kundërtën sepse ky OE i ka disponuar të gjitha mjetet e kërkuara, në dosjen e tenderit në piken: "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë: a.) 2 eskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale mbi 10t, b.) 3 kamiona me konstruksion ndërtim kiper me peshë totale mbi 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit), c.) 2 cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale minimum 7t, d.) 1 grejder, e.) 1 finisher ."

3. Gjatë auditimit, përkatësisht shqyrtimit dhe analizimit të lëndës së prokurimit nr. 632-20-1102-5-2-1, gjetëm që raporti i vlerësimit të ofertave është kontradiktor dhe nuk i pasqyron të gjitha informacionet e nevojshme.

Po ashtu gjetëm që dy OE të cilët kanë ofertuar me çmim më të ulët, kanë dështuar apo refuzuar që t'i ofrojnë informatat e kërkuar nga Autoritetit Kontraktues dhe si rezultat i mos ofrimit të informatave, Autoriteti kontraktues ka zgjedhe OE të tretë sipas renditjes i cili e ka ofertuar me çmimin më të ulët.

Gjetja konsiston në faktin që dy OE të cilët kanë ofertuar me çmim më të ulët, të cilët qëllimshëm nuk i kanë ofruar informacionet e kërkuara Autoritetit Kontraktues, është deshtë që Autoritetit Kontraktues të ju konfiskoj "SIGURIMIN E TENDERIT" , konform Nenit 57 Sigurimi i Tenderit të "Ligjit NR. 04/L-042 Për Prokurimin Publik Në Republikën E Kosovës"

#### Rekomandimet:

1. Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj nga sektori i prokurimit që ta ndërtoj bazën e të dhënave për të gjithë menaxheret e kontratave (projekteve) të Komunës së Gjakovës dhe që ta freskoj atë në mënyrë sistematike çdo herë kur nënshkruhet një kontratë e re dhe kjo listë të jetë dokument publik në ueb faqen e Komunës së Gjakovës në mënyrë
2. Rekomandojmë Menaxhmentin që të marr masa, në ristrukturimin e kontrolleve të brendshme në sektorin e Prokurimit dhe që vlerësime të tilla të mos përsëriten.Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj llogari dhe të identifikohet arsyeja se pse ka ardhur deri tek ky vlerësim i gabuar i ofertave.
3. Rekomandojmë Menaxhmentin që të marr masa, në ristrukturimin e kontrolleve të brendshme në sektorin e Prokurimit dhe që veprime të tilla të mos përsëriten.Rekomandojmë Menaxhmentin që të kërkoj llogari dhe të identifikohet arsyeja se pse ka ardhur deri tek ky mos veprim.

#### Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat):

#### **2. Rastet e moszbatimit ose zbatimit të gabuar të ligjit dhe dispozitave tjera ligjore, dhe dyshimeve për mashtrim**

2.1 Thekso shkurtimisht rastet e mos përmbajtjes ose zbatimit të gabuar të ligjeve dhe dispozitave tjera dhe dyshimit të mashtrimit të vërtetuara gjatë kryerjes së auditimit:

#### **3. Aktivitetet të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të**



<b>zbatimit të rekomandimeve të rëndësishme, si dhe moszbatimin e rekomandimeve të rëndësishme</b>
3.1 Shkurtimisht thekso aktivitetet e rëndësishme të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve nga raportet e auditimit:
3.2 Shkurtimisht përshkruaj rekomandimet e rëndësishme nga raportet e auditimit të cilat nuk janë zbatuar:
<b>4. Përfundimet kryesore të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit financiar dhe të kontrollit, si dhe rekomandimet e dhëna me qëllim të përmirësimit të afarizmit të subjektit të sektorit publik</b>
<b>5. Propozimet për zhvillimin e auditimit të brendshëm</b>
5.1 Theksoni shkurtimisht aktivitetet të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në subjektin tuaj të sektorit publik:
5.2 Propozimet e juaja për zhvillim dhe përparim të auditimit të brendshëm (në përgjithësi)
<b>Komentet:</b>



(Nënshkrimi i udhëheqësit të NjAB)



(Nënshkrimi i Udhëheqësit të SSP)